

V E N D I M
Nr.160, datë 8.4.1993

PËR REALIZIMIN E INVESTIMEVE SHTETËRORE ME SIPËRMARRJE

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe të Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Realizimi i të gjitha investimeve shtetërore të çdo forme të bëhet nëpërmjet konkurrimit të ofertave për sipërmarrjen.
2. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, organet e pushtetit lokal dhe ndërmarrjet shtetërore që financojnë këto investime, të organizojnë punën për hartimin e kërkesave kryesore tekniko-ekonomike për realizimin e investimeve.
3. Subjektet investitore shpallin me mjete të komunikimit masiv kërkesat tekniko-ekonomike, kushtet dhe afatet e konkurrimit.
4. Në konkurrim mund të marrin pjesë të gjithë personat juridikë, vendas a të huaj, që plotësojnë kushtet për pjesëmarrje në konkurrim.
5. Subjektet investitore të ngrenë komisionet përkatëse për shqyrtimin dhe përzgjedhjen e ofertave të sipërmarrjes. Këto komisione bëjnë klasifikimin e ofertave sipas leverdishmërisë dhe ia paraqesin për miratim titullarit të subjektit investitor.
6. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit të hartojë, brenda muajit maj të vitit 1993, projektligjin "Për investimet në ndërtim".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

V E N D I M